



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 210, datë 24.12.2024

PËR
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT
TË ADMINISTRIMIT TË SHOQËRISË
“ABI BROKER SIGURIMESH” SH.A.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të ligjit nr. 9572 datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” të ndryshuar, ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e riemërimit të znj. Veronika Prifti dhe z. Igli Sulaj, si anëtarë të Këshillit të Administrimit të shoqërisë “Abi Broker Sigurimesh” sh.a., për një mandat 3 vjeçar duke filluar nga data 21.11.2024.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, Departamenti i Licencimit, Mbrojtjes Konsumatore dhe Sjelljes së Tregut, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Idlir GJATA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI